



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2020-06

Prokurori kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit

Vendosi: Gjykatësi i Procedurës Paraprake

Gjykatës Nikola Giju

Administratore: Dr. Fidelma Donlon

Data: 11 janar 2021

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Konfidencial

Vendim mbi Kërkesën e Mbrojtjes së Thaçit për Leje për Apel

Prokurorit të Specializuar
Xhek Smith

Mbrojtësit të Hashim Thaçit
Dejvid Huper

Mbrojtësit të Kadri Veselit
Ben Emerson

Mbrojtësit të Rexhep Selimit
Dejvid Jang

Mbrojtëses së Jakup Krasniqit
Venkatesvari Alagenda

GJYKATËSI I PROCEDURËS PARAPRAKE,¹ në përputhje me nenin 45 të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (“Ligji”) dhe rregullën 77 të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës (“Rregullorja”), nxjerr këtë vendim.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 10 dhjetor 2020, Gjykatësi i Procedurës Paraprake (“GJPP”) nxori “Vendimin e Parë mbi Kërkesën e Prokurorit të Specializuar për Masa Mbrojtëse” (“Vendimi i Kundërshtuar”) me të cilin autorizoi masa mbrojtëse për një numër dëshmitarësh në të cilët mbështetet Zyra e Prokurorit të Specializuar (“ZPS”).²

2. Më 21 dhjetor 2020, Mbrojtja e Hashim Thaçit (“Mbrojtja e Thaçit”) parashtrioi “Kërkesën e Mbrojtjes në Emër të z. Thaçi për Leje për Apelim të ‘Versionit të Redaktuar Konfidencial të Versionit të Korrigjuar të Vendimit të Parë mbi Kërkesën e Prokurorit të Specializuar për Masa Mbrojtëse’” (“Kërkesa”), në të cilën kërkohet leje për apel në lidhje me katër pika që burojnë nga Vendimi i Kundërshtuar.³

3. Më 31 dhjetor 2020, ZPS-ja iu përgjigj Kërkesës (“Përgjigja e ZPS-së”).⁴ Tre të akuzuarit e tjerë nuk u përgjigjën dhe nuk iu bashkuan Kërkesës.

¹ KSC-BC-2020-06, F00001, Kryetarja, *Vendim për Caktimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake*, 23 prill 2020, publik.

² KSC-BC-2020-06, F00133/COR, *Version i Korrigjuar i Vendimit të Parë mbi Kërkesën e Prokurorit të Specializuar për Masa Mbrojtëse*, 10 dhjetor 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*. Versioni i redaktuar konfidencial i këtij vendimi iu njoftua Mbrojtjes më 14 dhjetor 2020, F00133/COR/CONF/RED.

³ KSC-BC-2020-06, F00156, Mbrojtja e Thaçit, *Kërkesë e Mbrojtjes në Emër të z. Thaçi për Leje për Apelim të ‘Versionit të Redaktuar Konfidencial të Versionit të Korrigjuar të Vendimit të Parë mbi Kërkesën e Prokurorit të Specializuar për Masa Mbrojtëse’*, 21 dhjetor 2020, konfidenciale.

⁴ KSC-BC-2020-06, F00157, Prokurori i Specializuar, *Përgjigje e Prokurorisë ndaj Kërkesës së Mbrojtjes së Thaçit për Leje për Apelim të Vendimit të Parë mbi Masat Mbrojtëse*, 31 dhjetor 2020, konfidenciale.

II. PARASHTRIMET

4. Mbrojtja e Thaçit parashtron katër pika për të cilat kërkon të apelojë Vendimin e Kundërshtuar:

- (1) nëse në lidhje me të gjitha masat e urdhëruara, GjPP-ja gaboi kur, lidhur me secilin dëshmitar në fjalë, nuk parashtroi arsyet specifike dhe konkrete për përfundimin e tij se nxjerrja për Mbrojtjen e identitetit të atij dëshmitari, në ndryshim nga nxjerrja për publikun, do të përbënte një rrezik objektivisht të arsyetueshëm për dëshmitarin, dhe në vend të kësaj u mbështet në frikën subjektive dhe deklaratat e përgjithësuara dhe të pabazuara, të cilat nuk tregojnë lidhjen e domosdoshme midis rrezikut të supozuar dhe Mbrojtjes.
- (2) nëse GjPP-ja gaboi që nuk kreu vlerësim individual për secilin dëshmitar, që duhet të kishte përfshirë një vlerësim të plotë dhe të kujdesëshëm lidhur me atë nëse masat e kërkuara ishin masat më pak kufizuese të nevojshme për të siguruar mbrojtjen e viktimave dhe dëshmitarëve.
- (3) nëse GjPP-ja përdori qasjen e gabuar për vlerësimin e proporcionalitetit të masave mbrojtëse të kërkuara, duke bërë së pari një konstatim përfundimtar në lidhje me faktin nëse masat ishin “proporcionale”, përpara se të shqyrtonte (dhe hidhte poshtë) shqetësimet e Mbrojtjes lidhur me ndikimin e atyre masave në të drejtën e të akuzuarit për gjykim të drejtë, ndërkohë që një vlerësim i duhur i proporcionalitetit të masave mbrojtëse duhet të kryhet “kundrejt cenimit që i shkaktohet të akuzuarit dhe gjyqimit të drejtë”.
- (4) nëse kur përligji miratimin e masave mbrojtëse në sallën e gjyqit mbi bazën e faktit se identiteti i dëshmitarëve “nuk do të nxirret vetëm për publikun”, dhe kur konstatoi se nuk kishte ndonjë mospërputhje midis masave mbrojtëse në sallën e gjyqit dhe të drejtave të akuzuarit pasi “i akuzuari do të dijë identitetin e dëshmitarit”, GjPP-ja gaboi që nuk mori parasysh faktorë të rëndësishëm si ndikimi i masave mbrojtëse në sallën e gjyqit mbi natyrën publike dhe transparente të procesit dhe efekti i tyre frenues mbi hetimet e Mbrojtjes në terren.⁵

⁵ Kërkesa, para. 12.

5. ZPS-ja përgjigjet se Gjykatësi i Procedurës Paraprake duhet të refuzojë Kërkesën pasi çështjet në fjalë (i) nuk janë pika “të apelueshme”,⁶ dhe (ii) nuk përmbushin kriteret ligjore të nenit 45 të Ligjit dhe rregullës 77 të Rregullores.⁷

III. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

6. Sipas nenit 45 të Ligjit, apelet e ndërmjetme të paraqitura nga i akuzuari apo nga Prokurori i Specializuar në pajtim me Ligjin dhe Rregulloren, shqyrtohen nga Paneli i Gjykatës së Apelit. Për apelet e ndërmjetme, përveç atyre që janë vetvetiu të lejueshëm, duhet të miratohet leje nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake ose Trupi Gjykues mbi bazën se kanë të bëjnë me çështje që do të ndikonin ndjeshëm në kryerjen e drejtë dhe të shpejtë të procesit ose në rezultatin e gjykimit dhe për të cilat, sipas mendimit të Gjykatësit të Procedurës Paraprake ose Trupit Gjykues, një vendim i menjëhershëm i Panelit të Gjykatës së Apelit mund të avancojë thelbësisht procesin gjyqësor.

7. Rregulla 77(2) e Rregullores përcakton më tej se Paneli miraton lejen në qoftë se vendimi lidhet me një çështje që do të ndikonte ndjeshëm në kryerjen e drejtë dhe të shpejtë të procesit, ose në rezultatin e gjykimit, ndër të tjera, në qoftë se mjetet e përshtatshme juridike praktikisht nuk do të mund të miratoheshin pas mbylljes së çështjes që gjykohet dhe për të cilën një vendim i menjëhershëm i Panelit të Gjykatës së Apelit mund të avancojë thelbësisht procesin gjyqësor.

⁶ Përgjigjja e ZPS-së, para. 1, 5, 6, 7, 8.

⁷ Përgjigjja e ZPS-së, para. 9.

IV. DISKUTIM

8. Para se të trajtojë çështjet e parashtruara nga Mbrojtja e Thaçit, Gjykatësi i Procedurës Paraprake e sheh të nevojshme të bëjë disa sqarime lidhur me standardin ligjor për miratimin e lejeve për apele të ndërmjetme.

A. STANDARDI LIGJOR

9. E drejta për apel lind vetëm nëse Paneli gjykon se është përmbushur standardi ligjor për miratimin e lejes për apel, i përcaktuar në nenin 45(2) të Ligjit dhe rregullën 77(2) të Rregullores.⁸ Apelet e ndërmjetme, që ndërpresin vijimësinë e procesit, janë përjashtim.⁹ Argumentet se një apel i ndërmjetëm do të trajtonte çështje themelore ose do të ishte i dobishëm për Dhomat e Specializuara në vetvete nuk përlligjin miratimin e lejes për apel.¹⁰

10. Duke pasur parasysh natyrën e kufizuar të këtij mjeti juridik, zbatohen kriteret e veçanta të mëposhtme:

(1) nëse çështja e ngritur përbën “një pikë të apelueshme”;

⁸ *Shih, për ngjashmëri, ICC, Situation in the Democratic Republic of the Congo, ICC-01/04-168, Judgment on the Prosecutor’s Application for Extraordinary Review of Pre-Trial Chamber I’s 31 March 2006 Decision Denying Leave to Appeal (“Judgment on Extraordinary Review”), 13 July 2006, para. 20.*

⁹ *Shih, për ngjashmëri, STL, Prosecutor v. Ayyash et al., STL-11-01/T/TC, Decision Denying Certification to Appeal Decision Under Rule 167 not to Acquit Hussein Hassan Oneissi and to Stay the Trial – With a Short Separate Opinion of Judge David Re (“Oneissi Decision Denying Certification to Appeal”), 14 May 2018, para. 8; ICC, Prosecutor v. Joseph Kony et al., ICC-02/04-01/05-20, Decision on Prosecutor’s Application for Leave to Appeal in Part Pre-Trial Chamber II’s Decision on the Prosecutor’s Applications for Warrants of Arrest Under Article 58 (“Kony Decision on Prosecutor’s Application for Leave to Appeal”), 19 August 2005, para. 18-19; ICTR, Prosecutor v. Arsène Shalom Ntahobali and Pauline Nyiramasuhuko, ICTR-97-21-T, Decision on Ntahobali’s and Nyiramasuhuko’s Motions for Certification to Appeal the “Decision on Defence Urgent Motion to Declare Parts of the Evidence of the Witnesses RV and QBZ Inadmissible” (“Decision on Ntahobali’s and Nyiramasuhuko’s Motions for Certification to Appeal”), 18 March 2004, para. 15.*

¹⁰ *Shih, për ngjashmëri, ICC, Prosecutor v. Dominic Ongwen, ICC-02/04-01/15-529, Decision on Defence Request for Leave to Appeal Decision ICC-02/04-01/15-521 (“Ongwen Decision on Defence Request for Leave to Appeal”), 2 September 2016, para. 8; Prosecutor v. Jean-Pierre Bemba Gombo, ICC-01/05-01/08-532, Decision on the Prosecutor’s Application for Leave to Appeal the “Decision Pursuant to Article 61(7)(a) and (b) of the Rome Statute on the Charges of the Prosecutor Against Jean-Pierre Bemba Gombo”, 18 September 2009, para. 12.*

(2) nëse pika në fjalë do të ndikonte ndjeshëm:

- i. në kryerjen e drejtë dhe të shpejtë të procesit, ose
- ii. në rezultatin e gjykimit; dhe

(3) nëse sipas mendimit të Panelit, një vendim i menjëhershëm i Dhomës së Apelit mund të avancojë thelbësisht procesin gjyqësor.

11. Vetëm një “pikë” mund të shërbejë si bazë për të apeluar një vendim. Termi “pikë” përkrahë si një temë ose lëndë e identifikueshme, zgjidhja e së cilës është kyçe për marrjen e vendimit mbi problemet që dalin në çështjen gjyqësore që shqyrtohet, dhe jo thjesht një temë për të cilën ka mospajtime ose mendime të kundërta.¹¹ Një pikë e apeluarshme kërkon prej parashtruesit të kërkesës që të shprehë qartë secilën prej pikave të veçanta që shtron për zgjidhje para Panelit të Gjykatës së Apelit, të cilat burojnë nga vendimi në fjalë dhe nuk përbëjnë tema abstrakte apo shqetësime hipotetike.¹² Zakonisht është e pamjaftueshme të argumentohet se arsyetimi i Gjykatësit të Procedurës Paraprake është i gabuar në tërësi.¹³

12. Nuk miratohet apel për çdo pikë të paraqitur. Elementi i parë i standardit të miratimit të lejes për apel, siç përcaktohet në pikën (b), përmban dy alternativa: pika duhet të ketë ndikim të ndjeshëm në (i) “kryerjen e drejtë dhe të shpejtë të procesit” ose (ii) “në rezultatin e gjykimit”.¹⁴ Përdorimi i termit “ndjeshëm” në formulimin e elementit të parë të standardit të miratimit të lejes për apel do të thotë se parashtruesi i kërkesës duhet jo vetëm të tregojë se si ndikon pika (i) në kryerjen e drejtë dhe të

¹¹ *Shih, për ngjashmëri*, ICC, ICC-01/04-168, Judgment on Extraordinary Review, para. 9.

¹² *Shih, për ngjashmëri*, ICC, *Prosecutor v. Jean-Pierre Bemba Gombo*, ICC-01/05-01/08-75, Decision on the Prosecutor’s Application for Leave to Appeal Pre-Trial Chamber III’s Decision on Disclosure (“*Bemba Decision on Prosecutor’s Application for Leave to Appeal*”), 25 August 2008, para. 11.

¹³ *Shih, për ngjashmëri*, ICC, ICC-02/04-01/15-529, *Ongwen* Decision on Defence Request for Leave to Appeal, para. 6; *Prosecutor v. William Samoei Ruto and Joshua Arap Sang*, ICC-01/09-01/11-596, Decision on the Joint Defence Request for Leave to Appeal the Decision on Witness Preparation, 11 February 2013, para. 11.

¹⁴ *Shih, për ngjashmëri*, ICC, ICC-01/04-168, Judgment on Extraordinary Review, para. 10.

shpejtë të procesit, ose (ii) në rezultatin e gjykimit, por duhet të demonstrojë edhe sa (ndjeshëm) ndikon në këta faktorë.¹⁵ Pika duhet të jetë e tillë që me gjasë të ndikojë ndjeshëm mbi njërin apo tjetrin prej dy elementëve të mësipërm.¹⁶

13. “Kryerja e drejtë dhe e shpejtë e procesit” përgjithësisht kuptohet se u referohet normave të gjykimit të drejtë.¹⁷ Parimet e gjykimit të drejtë nuk kufizohen me procesin e gjykimit, por përfshijnë edhe procedurën paraprake si dhe hetimin e një veprë penale.¹⁸ Shpejtësia, d.m.th. kryerja e gjykimit brenda një kohë të arsyeshme, ose, thënë ndryshe, kryerja e një gjykimi të shpejtë pa cenuar të drejtat e palëve pjesëmarrëse në të,¹⁹ është vetëm një prej tipareve të gjykimit të drejtë.²⁰ “Procesi” që përmendet si në elementin e parë dhe në atë të dytë të standardit të miratimit, i referohet tërësisë së procesit gjyqësor para Dhomave të Specializuara.²¹

14. Në alternativë, elementi i parë i standardit të miratimit mund të përmbushet nëse pika ndikon ndjeshëm në rezultatin e procesit gjyqësor. Rrjedhimisht, duhet shqyrtuar nëse një gabim i mundshëm në një vendim të ndërmjetëm do të ndikonte në rezultatin e çështjes gjyqësore. Ky shqyrtim përfshin edhe parashikimin e pasojave në një rast të tillë.²²

15. Elementi i dytë i standardit të miratimit është një tjetër faktor kufizues. Për shkak të natyrës kumulative të standardit, nëse parashtruesi i kërkesës nuk vërteton

¹⁵ *Shih, për ngjashmëri*, ICTR, Decision on Ntahobali’s and Nyiramasuhuko’s Motions for Certification to Appeal, para. 16.

¹⁶ *Shih, për ngjashmëri*, ICC, ICC-01/04-168, Judgment on Extraordinary Review, para. 10.

¹⁷ *Shih, për ngjashmëri*, ICC, ICC-01/04-168, Judgment on Extraordinary Review, para. 11.

¹⁸ *Shih, për ngjashmëri*, ICC, ICC-01/04-168, Judgment on Extraordinary Review, para. 11.

¹⁹ *Shih, për ngjashmëri*, ICC, ICC-01/05-01/08-75, *Bemba* Decision on Prosecutor’s Application for Leave to Appeal, para. 17-18.

²⁰ *Shih, për ngjashmëri*, ICC, ICC-01/04-168, Judgment on Extraordinary Review, para. 11.

²¹ *Shih, për ngjashmëri*, ICC, ICC-01/04-168, Judgment on Extraordinary Review, para. 12, 17.

²² *Shih, për ngjashmëri*, ICC, ICC-01/04-168, Judgment on Extraordinary Review, para. 13.

elementin e parë të standardit, kjo detyrimisht e bën të panevojshëm shqyrtimin prej Panelit nëse është përmbushur elementi i dytë.²³

16. Elementi i dytë i standardit të miratimit kërkon që të provohet se referimi i menjëhershëm i një pike për apelim Panelit të Gjykatës së Apelit do ta zgjidhë problemin dhe çlirojë “procesin gjyqësor nga gabimet e mundshme që, ose mund të njollosin drejtësinë e procesit, ose mund të dëmtojnë rezultatin e gjykimit”, duke mundësuar kështu mbarëvajtjen e duhur të procesit.²⁴

17. Së fundi, miratimi nuk ka të bëjë me atë nëse një vendim është arsyetuar drejt, por nëse është përmbushur standardi i miratimit.²⁵ Vendimi që shqyrton kërkesën për leje për apel nuk është mundësi për t’u shpjeguar palëve vendimin e kontestuar. Megjithatë, nëse është e nevojshme, Gjykatësi i Procedurës Paraprake do të japë sqarime kur është e qartë se kjo përlligjet prej shtrembërimit të vendimit.²⁶

B. PIKAT

Pika 1

18. Në lidhje me Pikën 1, Mbrojtja e Thaçit pretendon se lidhur me secilin dëshmitar përkatës, Gjykatësi i Procedurës Paraprake nuk përcaktoi lidhjen specifike dhe konkrete midis rrezikut të supozuar dhe Mbrojtjes, por u mbështet në “frikën

²³ *Shih, për ngjashmëri*, ICC, ICC-02/04-01/05-20, *Kony* Decision on Prosecutor’s Application for Leave to Appeal, para. 20-21; ICTR, Decision on Ntahobali’s and Nyiramasuhuko’s Motions for Certification to Appeal, para. 23-24.

²⁴ *Shih, për ngjashmëri*, ICC, ICC-01/04-168, Judgment on Extraordinary Review, para. 14-16, 18-19.

²⁵ *Shih, për ngjashmëri*, STL, *Oneissi* Decision Denying Certification to Appeal, para. 8; ICTY, *Prosecutor v. Radovan Karadžić*, IT-95-5/18-T, Decision on Accused’s Application for Certification to Appeal Denial of Motion for Judgement of Acquittal Under Rule 98 Bis, 18 July 2012, para. 6; ICTR, *Prosecutor v. Callixte Nzabonimana*, ICTR-98-44D-T, Decision on Defence Motion for Leave to Appeal the Trial Chamber’s Decision on the Defence Request to Call Prosecution Investigators, 10 May 2011, para. 12.

²⁶ *Shih, për ngjashmëri*, ICC, *Prosecutor v. Jean-Pierre Bemba Gombo*, ICC-01/05-01/08-75, Decision on Prosecutor’s Application for Leave to Appeal Pre-Trial Chamber III’s Decision on Disclosure, 25 August 2008, para. 9.

subjektive dhe deklaratat e përgjithësuara dhe të pabazuara”.²⁷ ZPS-ja përgjigjet se Gjykatësi i Procedurës Paraprake kreu një vlerësim individual lidhur me atë nëse nxjerrja për Mbrojtjen e identitetit të dëshmitarit përbënte rrezik objektivisht të identifikueshëm për atë dëshmitar dhe pretendon se Mbrojtja ka bërë një përshkrim të gabuar të faktorëve në të cilët mbështetet vendimi.²⁸

19. Gjykatësi i Procedurës Paraprake kujton standardin ligjor të zbatuar në Vendimin e Kundërshtuar,²⁹ sipas të cilit mosnxjerrja e informacionit për Mbrojtjen mund të lejohet nëse konstatohet se nxjerrja e atij informacioni për Mbrojtjen, në ndryshim nga nxjerrja për publikun, do të krijonte një rrezik objektivisht të identifikueshëm për personin e mbrojtur.³⁰ Në Vendimin e Kundërshtuar, Gjykatësi i Procedurës Paraprake ka parashtruar faktorin ose faktorët konkretë përkatës për secilin dëshmitar (të identifikuar me pseudonim në kllapa) mbi të cilët mbështetet përfundimi se një rrezik i tillë ekziston si rezultat i nxjerrjes së informacionit për Mbrojtjen. Për këtë arsye, pretendimi i Mbrojtjes se Gjykatësi i Procedurës Paraprake zbatoi gabimisht standardin ligjor, pa treguar lidhjen midis rrezikut të supozuar objektivisht të identifikueshëm dhe Mbrojtjes, nuk buron nga Vendimi i Kundërshtuar. Gjithashtu, Mbrojtja nuk përcakton qartë shembullin dhe dëshmitarin konkret në të cilin është mbështetur Gjykatësi i Procedurës Paraprake, dhe as faktorët që përbëjnë “frikë subjektive dhe deklarata të përgjithësuara dhe të pabazuara”. Pohime të tilla kaq të gjëra nga Mbrojtja e Thaçit shprehin një mospajtim të përgjithshëm por nuk arrijnë të identifikojnë pika që burojnë nga Vendimi i Kundërshtuar. Rrjedhimisht, Mbrojtja e Thaçit nuk ka paraqitur një pikë të apelueshme që rrjedh nga Vendimi i Kundërshtuar.

Pika 2

²⁷ Kërkesa, para. 12-13.

²⁸ Përgjigja e ZPS-së, para. 5.

²⁹ *Shih, për shembull*, Vendimi i Kundërshtuar, para. 22, 34, 53, 61, 79-81, 92, 102, 109.

³⁰ Vendimi i Kundërshtuar, para. 20.

20. Në lidhje me Pikën 2, Mbrojtja e Thaçit kundërshton faktin që Gjykatësi i Procedurës Paraprake shqyrtoi dëshmitarët në grupe dhe nuk kreu vlerësim individual për secilin dëshmitar përkatës, duke përfshirë vlerësimin mbi domosdoshmërinë e masave mbrojtëse.³¹ ZPS-ja përgjigjet se Gjykatësi i Procedurës Paraprake kreu vlerësim individual dhe shtjelloi faktorët për secilin dëshmitar, dhe se identifikimi i një faktori të përbashkët për të gjithë dëshmitarët nuk nënkupton që vlerësimi nuk është i individualizuar.³² Sipas mendimit të ZPS-së, ndarja në grupe e dëshmitarëve në Vendimin e Kundërshtuar nuk ndikon aspak në natyrën e vlerësimit; rrjedhimisht, ajo çka ngre Mbrojtja është një çështje stili por jo përmbajtjeje.³³

21. Gjykatësi i Procedurës Paraprake rikujton se, siç shtjellohet më lart, në Vendimin e Kundërshtuar vlerësimi u individualizua për secilin dëshmitar, duke përfshirë kriterin e domosdoshmërisë,³⁴ dhe se, për arsye të paraqitjes, dëshmitarët u ndanë në grupe sipas masës mbrojtëse përkatëse dhe nxjerrjes së informacionit lidhur me të gjatë procesit gjyqësor (“kategoritë e dëshmitarëve”). Gjithashtu, vlen të rikujtohet se secili dëshmitar është përfshirë qartë në kategorinë përkatëse të dëshmitarëve, së bashku me faktorin ose faktorët në të cilët është mbështetur Gjykatësi i Procedurës Paraprake. Pretendimi i Mbrojtjes së Thaçit se, për shkak të shqyrtimit të dëshmitarëve në grupe, nuk është kryer vlerësimi individual i tyre, nuk ka asnjë bazë në Vendimin e Kundërshtuar. Rrjedhimisht, Mbrojtja e Thaçit nuk ka paraqitur një pikë të apelueshme që rrjedh nga Vendimi i Kundërshtuar.

Pika 3

22. Në lidhje me Pikën 3, Mbrojtja e Thaçit pretendon se Gjykatësi i Procedurës Paraprake nuk shqyrtoi në mënyrën e duhur proporcionalitetin kur autorizoi masat

³¹ Kërkesa, para. 12, 14.

³² Përgjigja e ZPS-së, para. 6.

³³ Përgjigja e ZPS-së, para. 6.

³⁴ *Shih, për shembull*, Vendimi i Kundërshtuar, para. 36, 42, 55, 62, 83, 94, 103.

mbrojtëse “të cilat do të ndikojnë ndjeshëm në aftësinë e Mbrojtjes për të hetuar dhe për t’u përballur në mënyrë efektive dhe efikase me provat në gjykim”.³⁵ Në veçanti, duke iu referuar paragrafëve 96-97 të Vendimit të Kundërshtuar, Mbrojtja pretendon se Gjykatësi i Procedurës Paraprake gaboi që bëri konstatim përfundimtar përpara se të shqyrtonte dhe hidhte poshtë shqetësimet e Mbrojtjes për këtë çështje.³⁶ ZPS-ja përgjigjet se Mbrojtja shtrembëron Vendimin e Kundërshtuar.³⁷

23. Gjykatësi i Procedurës Paraprake rikujton se masat mbrojtëse duhet të jenë proporcionale kundrejt cenimit që i shkaktohet të akuzuarit dhe gjykit të drejtë.³⁸ Mbrojtja e Thaçit duket se e kundërshton analizën e Gjykatësit të Procedurës Paraprake në lidhje me vetëm gjashtë dëshmitarë, për të cilët ishte kërkuar nxjerrje e identitetit 30 ditë përpara dhënies së dëshmive të tyre përkatëse.³⁹ Në kundërshtim me pretendimet e Mbrojtjes së Thaçit, përfundimi në paragrafin 96 të Vendimit të Kundërshtuar ka të bëjë me proporcionalitetin e masave mbrojtëse lidhur me gjashtë dëshmitarët në fjalë, ndërsa vlerësimi dhe përfundimi në paragrafin 97 të Vendimit të Kundërshtuar shtjellon ndikimin e gjithsejtë mbi të drejtat e Mbrojtjes të këtyre masave mbrojtëse dhe të masave mbrojtëse tashmë të autorizuara lidhur me pesë dëshmitarë të tjerë.⁴⁰ Në këtë kontekst, vlen të përmendet se konstatimet në paragrafin 97 të Vendimit të Kundërshtuar janë rezultat i shqetësimeve të shprehura nga Mbrojtja e Thaçit në lidhje me ndikimin e pretenduar të masave ndaj aftësisë së Mbrojtjes për të kundërshtuar akuzat e ZPS-së dhe për të kryer hetimet e duhura përpara dhënies

³⁵ Kërkesa, para. 15.

³⁶ Kërkesa, para. 12, 15.

³⁷ Përgjigjja e ZPS-së, para. 7.

³⁸ Vendimi i Kundërshtuar, para. 20. Për secilin dëshmitar u bë një vlerësim mbi proporcionalitetin e masave, *shih, për shembull*, Vendimi i Kundërshtuar, para. 37-39, 43-44, 56-58, 63-64, 84-88, 95-98, 104-105.

³⁹ Vendimi i Kundërshtuar, para. 89-98.

⁴⁰ *Shih* Vendimi i Kundërshtuar, para. 68-72 dhe poshtëshënimi 171. Vlen të rikujtohet se masat mbrojtëse tashmë të autorizuara në procese të tjera gjyqësore vazhdojnë të jenë në fuqi në procesin gjyqësor aktual dhe nuk ka nevojë për një vlerësim *de novo* të tyre. *Shih* rregulla 81(1)(a) e Rregullores.

së dëshmime nga dëshmitarët.⁴¹ Mjafton të thuhet se Mbrojtja e Thaçit shtrembëron Vendimin e Kundërshtuar kur pretendon se Gjykatësi i Procedurës Paraprake nuk vlerësoi në mënyrën e duhur elementin e proporcionalitetit. Rrjedhimisht, Mbrojtja e Thaçit nuk ka paraqitur një pikë të apelueshme që rrjedh nga Vendimi i Kundërshtuar.

Pika 4

24. Në lidhje me Pikën 4, Mbrojtja e Thaçit parashtron se, si rezultat i Vendimit të Kundërshtuar, publiku nuk do t'i dijë identitetet e 71 dëshmitarëve, çka rrjedhimisht cenon ndjeshëm të drejtën themelore të z. Thaçi për gjykim publik.⁴² Mbrojtja e Thaçit gjithashtu pretendon se Gjykatësi i Procedurës Paraprake nuk shqyrtoi në mënyrën e duhur ndikimin e madh të masave mbrojtëse në sallën e gjyqit mbi hetimet e Mbrojtjes.⁴³ ZPS-ja përgjigjet se Mbrojtja e Thaçit shtrembëron Vendimin e Kundërshtuar, duke qenë se ndikimi i masave mbrojtëse në sallën e gjyqit mbi hetimet e Mbrojtjes është shqyrtuar në kuadër të argumenteve të ngritura nga Mbrojtja e Rexhep Selimit ("Mbrojtja e Selimit").⁴⁴

25. Gjykatësi i Procedurës Paraprake rikujton se masat mbrojtëse në sallën e gjyqit për dëshmitarët në fjalë u autorizuan pas zbatimit të standardit ligjor të përcaktuar në paragrafin 20 të Vendimit të Kundërshtuar.⁴⁵ Gjithashtu, vlen të rikujtohet se kur vendos lidhur me masat mbrojtëse në sallën e gjyqit, Gjykatësi i Procedurës Paraprake mban parasysh faktin se parimi i publicitetit i nënshtrohet disa përjashtimeve dhe duhet të balancohet me interesat e tjera të përfshira, siç janë ato të dëshmitarëve të mbrojtur. Së fundi, Gjykatësi i Procedurës Paraprake rikujton se masat në sallën e

⁴¹ *Shih* Vendimi i Kundërshtuar , poshtëshënimi 170.

⁴² Kërkesa, para. 16, 18.

⁴³ Kërkesa, para. 16.

⁴⁴ Përgjigjja e ZPS-së, para. 8.

⁴⁵ Vendimi i Kundërshtuar , para. 114.

gjqit të autorizuar “nuk cenojnë asnjë vendim të ardhshëm të Trupit Gjykses në lidhje me këtë”.⁴⁶

26. Mbrojtja e Thaçit ankohet se 71 dëshmitarë do të japin dëshmi me një publik që nuk do të dijë identitetet e tyre (për dallim nga Mbrojtja e Thaçit). Në të njëjtën kohë, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se Mbrojtja e Thaçit duket se e pranon, në përgjithësi, domosdoshmërinë e masave mbrojtëse për dëshmitarët, në qoftë se është e përligjur.⁴⁷ Veçse që mbështetet në të drejtën për gjykim publik dhe numrin e përgjithshëm të dëshmitarëve që përfitojnë përkohësisht nga masat mbrojtëse në sallën e gjyqit, në lidhje me këtë pikë Mbrojtja e Thaçit ofron një argument spekulativ pasi vendimi përfundimtar në lidhje me masat mbrojtëse në sallën e gjyqit për dëshmitarët që do të thirren për të dëshmuar në gjykim do të merret nga Trupi Gjykses.⁴⁸ Asgjë nuk e pengon Mbrojtjen e Thaçit që, sipas rastit, të kërkojë masën e duhur ndreqëse në gjykim. Rrjedhimisht, kjo pikë paraqet një shqetësim hipotetik që nuk ka lindur në rrethanat e tanishme dhe prandaj nuk mund të shërbejë si bazë për apelim. Gjithashtu, vlen të rikujtohet se, sikurse përcaktohet në Vendimin e Kundërshtuar, kur shqyrtoi masat mbrojtëse në sallën e gjyqit, Gjykatësi i Procedurës Paraprake mori parasysh dhe i kushtoi vëmendjen e duhur shqetësimin në lidhje me ndikimin e pretenduar të këtyre masave mbi hetimet e Mbrojtjes.⁴⁹ Për këtë arsye, këmbëngulja se nuk është kështu por është ndryshe, thjesht pasqyron një konflikt mendimesh. Rrjedhimisht, Mbrojtja e Thaçit nuk ka paraqitur një pikë të apalueshme.

Përfundim

⁴⁶ Vendimi i Kundërshtuar , para. 113.

⁴⁷ *Shih, për shembull, KSC-BC-2020-06, F00129, Mbrojtja e Thaçit, Përgjigje e Mbrojtjes së Thaçit ndaj “Kërkesës për Masa Mbrojtëse”, KSC-BC-2020-06/F00094, datë 19 nëntor 2020 me Shtojcën Konfidenciale 13”, 8 dhjetor 2020, para. 3, 9, 36, 118.*

⁴⁸ *Shih gjithashtu KSC-BC-2020-06, F00129, Mbrojtja e Thaçit, Përgjigje e Mbrojtjes së Thaçit ndaj “Kërkesës për Masa Mbrojtëse”, KSC-BC-2020-06/F00094, datë 19 nëntor 2020 me Shtojcën Konfidenciale 13”, 8 dhjetor 2020, para. 114.*

⁴⁹ *Shih Vendimi i Kundërshtuar , poshtëshënimi 196.*

27. Pasi ka konstatuar se asnjë nga parashtrimet e Mbrojtjes së Thaçit nuk buron nga Vendimi i Kundërshtuar, Gjykatësi i Procedurës Paraprake nuk do të vijojë me vlerësimin e pjesës së mbetur të standardit ligjor.

C. KLASIFIKIMI

28. Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se Kërkesa dhe Përgjigjja e ZPS-së janë klasifikuar si konfidenciale, pasi ato lidhen me Vendimin e Kundërshtuar që mban të njëjtin klasifikim.⁵⁰ Me qëllim që të respektohet parimi i publicitetit, Gjykatësi i Procedurës Paraprake e konsideron të nevojshme të urdhërojë palët që të bëjnë të ditur, me anë të një parashtrimi të protokolluar, nëse parashtrimet e tyre përkatëse mund të bëhen publike, ose të dorëzojnë versione të redaktuara publike të parashtrimeve të tyre përkatëse, sipas rastit. Më pas, ky vendim do të riklasifikohet si publik.

V. VENDIM

29. Për arsyet e lartpërmendura, Gjykatësi i Procedurës Paraprake

- a) **REFUZON** Kërkesën; dhe
- b) **URDHËRON** palët që deri të **premtën, 15 janar 2021**, të bëjnë të ditur, me anë të një parashtrimi të protokolluar, nëse parashtrimet e tyre përkatëse (F00156 dhe F00157) mund të bëhen publike, ose të dorëzojnë versione të redaktuara publike të parashtrimeve të tyre, sipas rastit.

/nënshkrimi/

Gjykatës Nikola Giju
Gjykatësi i Procedurës Paraprake

⁵⁰ Rregulla 82(4) e Rregullores.

E hënë, 11 janar 2021
Në Hagë, Holandë.